



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Prilajeno Më/Dana 17.07.2012			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-013	865		

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 pika d) lidhur me nenin 40.2 pika c) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 pika c) të Statutit të Komunës së Vitisë 01-013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 13.07. 2012 aprovon këtë:

**V E N D I M**  
**PËR RIDESTINIMIN E MJETEVE BUXHETORE PËR PESË MUAJT E VITIT 2012**

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi Komunës së Vitisë, lejon ridestinimin e mjeteve buxhetore për pesë muajt e vitit 2012, gjegjësisht bartjen e mjeteve prej një programi në programin tjetër dhe atë:

**Transferet nga pagat e mëditje në paga e mëditje:**

-Nga Programi Buxhet e Financa të bartet shuma prej 500€ në programin Zyra e Komuniteteve.

**Transferet nga pagat e mëditje në shërbime dhe mallra:**

-Nga programet: Buxhet e Financa 2.300€, Zyra e Kryetarit 1.200€, Infrastruktura publike 2.200€, Kadastër dhe Gjeodezi 3.500€, Kulturë, Rini dhe Sport 1.000,00€ – gjithsejtë 10.200€ të barten në Kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime të programit Shërbime Publike nënprogrami infrastruktura publike.

Nga kategoria ekonomike paga e mëditje të programit Arsim e Shkencë – Administrata 1.000,00€ dhe Arsim e Shkencë – Arsimi fillor 3.000,00€ - gjithsejtë 4.000,00€ barten në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime në Administratën e Arsimit.

**Transferet nga projektet kapitale Fondi burimor 10**

Nga Projekti participim në projekte me komunitete dhe donator 60.469,06€, Asfaltimi i rrugës “Dëshmorët e Kombit” në Viti 19.309,40€, Rregullimi i rrethojave në shkollat fillore Fshati i Ri 8.778,62€ dhe Zgjerimi dhe shtruarja e trotuarit me zhavorr të rrugës Fshat i Ri – Ramjan 14.020,95€ të barten në projektin **Ndërtimi i shkollës fillore- Sllatina e Epërme** – faza e dytë në shumë prej 102.578.03€.

Nga projekti ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Ramjan shuma prej 70.000€ të bartet në projektin **Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Ramjan.**

**Transferet nga projektet kapitale Fondi burimor 21**

Nga participimi në projekte me komunitete dhe donator, 102.501€ barten në projektin **Ndërtimi i shkollës fillore- Sllatinë e Epërme faza e dytë.**

Nga participimi në projekte me komunitete dhe donator 16.000€ dhe nga projekti kanalizimi në fshatin Remnik 55.330.08€ gjithsejtë 71.330,08€, barten në projektin **Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Kabash faza e dytë.**

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi dhe nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi i dërgohet:

1. Ministrisë për Financa
2. Drejtorisë për Financa,
3. Në dosje të Kuvendit,
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebibi

